

“STEMspresso-lokal - Promovimi i grave në STEM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri, dhe Matematikë) nga të rinjtë për të rinjtë”

STEMtalk Shkodër

08 Prill 2022

Ora 16:00 – 17:30

Vendi: Qendra Rinore Atelie

SCiDEV në kuadër të programit të Rrjetit të Grave Shqiptare në STEM, po implementon projektin “STEMspresso lokal - Promovimi i grave në STEM nga të rinjtë për të rinjtë”. Qëllimi i projektit është të kontribuojë në rritjen e vizibilitetit të grave dhe vajzave shqiptare në STEM dhe të ndërtojë një kulturë edukimi STEM mes të rinjve në Shqipëri.

Në këtë kuadër, projekti parashikon një seri aktivitesh, mes të cilave, angazhimin dhe trajnimin e 36 të rinjve për të krijuar materiale multimediale për rritjen e vizibilitetit të grave në STEM.

Të rinjtë e përzgjedhur do të organizohen në ekipe me nga katër persona, 3 ekipe për secilin qytet, Durrës, Shkodër, Pogradec, dhe do të trajnohen nga dy ekspertë për zhvillimin e përmbajtjes multimediale, në formën e podcasteve dhe videove, në total 3 podcaste dhe 6 video, të cilat do të shërbejnë për të rritur ndërgjegjësimin dhe vizibilitetin e grave dhe vajzave shqiptare në STEM si dhe rëndësinë e kësaj forme arsimimi.

Një prej aktiviteteve para të projektit është organizimi i STEMtalks në bashkëpunim me organizatat lokale në fushën e barazisë gjinore në Durrës, Shkodër, Pogradec. STEMtalks janë takime të hapura me të rinjtë në secilin qytet ku një anëtare e Rrjetit të Grave Shqiptare në STEM do të bashkëbisedojë me ta rreth rëndësisë së edukimit në STEM, perspektivat e karrierës në STEM në akademi dhe industri, sfidat, mundësitë dhe përfitimet për zhvillimin social dhe ekonomik të vajzave dhe grave përmes përfshirjes dhe përfaqësimit në STEM.

Ky projekt zbatohet nga SCiDEV me mbështetjen e UNDP Shqipëri, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si pjesë e Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “T’i japim fund dhunës ndaj grave në Shqipëri”, financuar nga Qeveria e Suedisë.

STEMtalk Shkodër

Agjenda

08 Prill 2022

Ora 16:00 – 17:30

Vendi: Qendra Rinore Atelie

Ky aktivitet zhvillohet në bashkëpunim me organizatën vendore "Gruaja tek Gruaja"

15:45 –	Regjistrimi i pjesëmarrësve	
16:00 – 16:05	Mirëseardhje	Znj. Suela Domnori Psikologe, Shoqata "Gruaja tek Gruaja", Shkodër
16:05 – 16:15	Prezantimi i Projektit "STEMspresso-lokal - Promovimi i grave në STEM nga të rinjtë për të rinjtë"	Znj. Blerjana Bino Drejtor Ekzekutiv, Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim, SciDEV Bashkëthemeluese e Rrjetit të Grave Shqiptare në STEM
16:15 – 16:45	Udhëtimi im në STEM: Përfitimet, mundësitë, sfidat dhe mësimet për brezat e rinj	Prof. Asoc. Dr. Teuta Xhindi Përgjegjëse e Departamentit të Informatikës dhe Formimit Shkencor Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë Anëtare e Rrjetit të Grave Shqiptare në STEM
16:45 – 17:15	Diskutim i hapur dhe bashkëbisedim	
17:15 – 17:30	Reflektime përfundimtare dhe hapat e mëtejshëm	Znj. Suela Domnori Psikologe, Shoqata "Gruaja tek Gruaja", Shkodër Znj. Blerjana Bino Drejtor Ekzekutiv, Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim, SciDEV Bashkëthemeluese e Rrjetit të Grave Shqiptare në STEM
17:00 -	Vazhdim i bashkëbisedimit me një filxhan Çaj / Kafe	